

VENDIM
Nr.217, datë 15.4.2005

**PËR PËRCAKTIMIN E DISA SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE, SPITALORE, PUBLIKE,
PËR T'U DHËNË ME KONCESION, ME MARRËVESHJE OSE KONTRATA
SHFRYTËZIMI, ADMINISTRIMI APO MIRËMBAJTJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 11 të nenit 3 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e shërbimeve shëndetësore, spitalore, publike, si të lavanderisë, pastrimit, kateringut, mirëmbajtjes së ndërtesave spitalore e të impianteve teknologjike të tyre dhe të parkimit të automjeteve, për t'u dhënë me koncesion, me marrëveshje ose kontrata të tjera shfrytëzimi, administrimi apo mirëmbajtje.

2. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë, me cilësinë e organit shtetëror të autorizuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano